



## KËRKESË PENALE

- NGA:** Partia Demokratike e Shqipërisë  
Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit të PDSH-së
- I AKUZUAR:** Kreshnik Çollaku, i biri i Shabanit dhe i Dolorezës, i lindur më 07.09.1970, lindur dhe banues në Tiranë, me Nr.ID 036586402, me adresë njoftimi: *Selia e forcës politike "Partia Demokratike", pranë Bankës Kombëtare Tregtare, me Kod postar 1001, Tiranë.*
- OBJEKTI:** Gjykimin e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale të "Shpifjes", të parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 17, 22, 23 e 73 të Kushtetutës, Neni 8 dhe 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 120 i Kodit Penal dhe Nenet 58, 59, 60, 69, 75 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.
- DREJTUAR:** GJYKATËS SË POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

I/E nderuar Kryetar/e i/e Seancës,

Ne Anëtarët e Komisionit të Rithemelimit, me cilësinë e viktimave akuzuese, duke shprehur konsideratat tona për Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i drejtohem i kësaj të nderuare gjykatë, me një kërkesë me palë të akuzuar deputetin e Partisë Demokratike të Shqipërisë Kreshnik Çollaku.



I- Juridiksioni dhe kompetenca:

1. Referuar Kodit të Procedurës Penale, juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod si dhe Gjykata penale (në rastin konkret GJKKO), shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj.
2. Bazuar në këtë Kod si dhe vendimin e Gjykatës së Lartë në çështjen penale me viktimë L.B dhe të akuzuar E.V, kërkesat penale janë kompetencë e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II- Analiza e rrethanave dhe e fakteve:

3. Sipas debateve me dyer të mbyllura në Kryesinë (e shkarkuar tashmë në Kuvendin e datës 11 dhjetor 2021), më datë 12 janar 2022, deputeti i Partisë demokratike Kreshnik Çollaku, ka deklaruar se Berisha po mbështetet nga influencat ruse dhe Kisha Ortodokse.
4. Në mënyrë të qëllimshme, këto deklarata në formë të shpifjes të deputetit Kreshnik Çollaku, u shpërndanë në të gjitha mediat audio vizive, në të gjitha mediat e shkruara dhe rrjetet sociale (Boldnews.al, Panorama.al etj.).
5. Sipas publikimit të Boldnews.al (bashkëngjitue kërkesës), thuhet se: “Debati me dyer të mbyllura në PD/ Çollaku: “Berisha po mbështetet nga influencat ruse dhe Kisha Ortodokse”.
6. Kjo deklaratë e deputetit Kreshnik Çollaku për situatën ku ndodhet Partia Demokratike pas Kuvendit të datës 11 dhjetor 2021 dhe Referendumit të miratimit të shkarkimit të ish Kryetarit Basha të datës 18 dhjetor 2021, ishin tejet të rënda që me anë të shpifjes jo vetëm rrisnin tensionet brenda forcës politike Partia Demokratike, por krijonin përçarje brenda besimeve të ndryshme fetare të antarësisë së Partisë Demokratike.



## Partia Demokratike

7. Edhe portali gazeta panorama.com.al, pasqyroi faktin se deputeti Kreshnik Çollaku në mbledhjen me dyer të mbyllura në Selinë e Partisë Demokratike është shprehur se: “Berisha po mbështetet nga influencat ruse dhe Kisha Ortodokse”, por nga kërkimet çuditërisht ky publikim është fshirë, duke e bërë të pamundur ta sjellim përpara Gjykatës.

8. Këto deklaratatë lëshuar qëllimisht në kulmin e krizës brenda Partisë Demokratike nga deputeti Kreshnik Çollaku, edhe pas dhunës së ushtruar ndaj protestuesve të Partisë Demokratike nga Policia e Shtetit por edhe e njerëzve të armatosur brenda Selisë së kësaj partie nga mbështetësi të ish Kryetarit Basha më 8 janar 2022, kërkojnë të manipulojnë opinionin publik që jo vetëm kjo lëvizje financohet nga burime të dyshimta, por ato janë burime që lidhen me mbështetje nga forca destruktive anti shqiptare dhe me besime fetare të ndryshëm nga ai mysliman.

9. Nisur nga fakti se ne nuk e kemi këtë deklaratë nga deputeti Kreshnik Çollaku (pasi mbledhja është mbajtur me dyer të mbyllura), kërkojmë që nga ana e Gjykatës t'i kërkohet këtyre mediave vënia në dispozicion të këtij informacioni shumë delikat dhe me ndikim shumë negativ në anëtarësinë e Partisë Demokratike.

10. Po kështu, nisur nga deklaratatë e deputetes Duma në emisionin Open në Top Chanel, se të gjitha debatet në Kryesi apo Grup Parlamentar regjistrohen, kërkojmë që Gjykata të detyrojë administratën e Partisë Demokratike që të vërë në dispozicion të gjitha regjistrimet që disponojnë (datë 12 janar 2022) lidhur me këtë deklaratë qëllimisht shpifëse kundër Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit në Partinë Demokratike në përgjithësi si dhe Prof. Dr. Sali Berishës në veçanti.

### *III- Analiza e argumentave ligjorë:*

11. Fyrjet apo etiketimet e kësaj kategorie nga ana e të akuzuarit Kreshnik Çollaku, konfirmojnë jo vetëm konsumimin e të gjithë elementëve të veprës penale të “Shpifjes”, parashikuar nga Neni 120 i Kodit Penal, por edhe qëllimin e përçarjes midis besimeve të ndryshme fetare të antarësisë së Partisë Demokratike.

12. Në këtë deklaratë të të akuzuarit Kreshnik Çollaku, është konsumuar vepra penale e shpifjes për sa kohë që ai, drejtohet me fakte konkrete (sipas tij) dhe me informacione të sigurta.



## Partia Demokratike

13. Nëpërmjet këtyre prononcimeve publike në *media apo rrjete sociale*, e shpërndarë në kohë rekord, vetëm brenda disa minutash është ndjekur nga miliona ndjekës këto deklaramë për një sërë faktesh të pavërteta, të ngritura mbi shpifje.

14. Këto fakte të pavërteta, janë bërë me qëllimin kriminal për dëmtimin e reputacionit dhe imazhit ndaj personave të zgjedhur si Anëtarë të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike, me cilësinë e të viktimave akuzuese si dhe, të gjitha këto deklaramë shpifëse i akuzuari prej viktimave akuzuese i përdor për të përfituar kredo politike përballë qytetarëve dhe për të ulur reputacionin e Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike.

15. Qëllimi i shpifjeve është që të barazojë në perceptimin e publikut, jo vetëm palët në konfliktin brenda Partisë Demokratike, por edhe t'i tregojë dhe manipulojë publikun se këta (Anëtarët e Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike), përfaqësojnë klika të ndryshme fetare antishqiptare dhe pikërisht ato jo myslimane, duke i paraqitur si persona me integritet të ulët ndaj të cilëve nuk mund të besohet.

16. Këto deklaramë pa fakte dhe prova dhe të pavërteta dhe të bëra në shpifje nga i akuzuari Kreshnik Çollaku, kërkojnë të manipulojnë publikun se viktimat akuzuese po përdorin çdo formë apo burim financimi për marrjen e Selisë së Partisë Demokratike, sidomos duke e orientuar publikun dhe demokratët në ato rrjete fetare të cilat njohen si anti myslimane.

17. Siç vihet re nga deklaramë e të akuzuarit, vihet në dukje se ato jo vetëm financohen nga qarqe jashtë Shqipërisë, por ato janë dukshëm jo të besimit mysliman.

18. Në këto kushte, natyrshëm na lind pyetja se:

**a- Nga e ka marë informacionin i akuzuari Kreshnik Çollaku?**

**b- A e ka referuar këtë informacion shumë delikat në organet ligjzbatuese sidomos ato të parandalimit të pastrimit të parasë?**

**c- A ka bërë kallëzim në Organin e Akuzës lidhur më këtë informacion shumë të rëndësishëm?**



**19.** Një nga parimet themelore të bashkëjetesës në shoqërinë njerëzore është ndalimi për t'i shkaktuar dëm tjetrit (*alterum non laedere* ose *neminem laedere*).

I akuzuari me vetëdije të plotë, duke qenë i bindur që po shpif dhe pa u mbështetur në asnjë burim të konfirmuar dhe zyrtar që të vërtetojë këto shpifje të kryera botërisht nga ana e tij, ka dashur të sulmojë në mënyrë të pandershme viktimat akuzuese, duke dashur të çënojë reputacionin dhe personalitetin e tyre.

**20.** Të ndodhur në këto kushte, ne me cilësinë e viktimave akuzuese, kërkojmë të rivendoset në vend e drejta e nderit dhe e dinjitetit të tyre, duke i kërkuar gjykatës të thërrasë në cilësinë e të akuzuarit deputetin Kreshnik Çollaku, ta gjykojë dhe ta dënojë atë për kundërvajtjen penale të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 120 të Kodit Penal, e cila më konkretisht parashikon se:

*“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që çënojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.*

***Po kjo veprë , kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”.***

**21.** Nga përmbajtja dhe interpretimi i dispozitave të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, Nenet 17, 22 e 23 të Kushtetutës, si dhe Nenet 8 dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parimisht nxjerrim konkluzionin se liria e shprehjes dhe e informimit është e garantuar dhe e mbrojtur nga ligji për këdo, por kjo liri mund t'u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj në rastet kur (veç të tjerash) prek moralin, nderin, dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve.

**22.** Parashikimi në Kodin Penal i veprave penale të fyerjes dhe shpifjes dhe sanksionet që përmbajnë ato, janë pikërisht masat që me ligj janë marrë për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit të personit.

**23.** Që të konsiderohet e konsumuar vepra penale e shpifjes, ajo duhet të kryhet nëpërmjet përhapjes së qëllimshme të thënieve, ose çdo informacioni tjetër duke e ditur që janë të rreme si dhe botërisht.



24. I akuzuari ka përhapur publikisht informacionin e rremë, me qëllim dëmtimin e imazhit publik të Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike në përgjithësi si dhe të Prof. Dr. Sali Berishës në veçanti, me cilësinë e viktimave akuzuese, me qëllimin e vetëm për të cënuar me pa të drejtë këta persona dhe për të përfituar kredo politike personale. Po kështu, shpifja është bërë me qëllimin e vetëm për ta bërë edhe më të besueshme shpifjen e cituar edhe më parë në mënyrë që të lihet gjurmë të publiku, nisur edhe nga fakti i ndjekjes mjaft të madhe që ka në publik konflikti brenda Partisë Demokratike, e lidhur kjo si me Kuvendin Kombëtar të datës 11 dhjetor 2021 thirrurr nga Delegatët ashtu edhe të Referendumit për ratifikimin e shkarkimit të ish Kryetarit Basha më 18 dhjetor 2021.

25. Një sjellje e tillë, tregon qartazi dashjen direkte të tij (të akuzuarit) për të deklaruar publikisht fakte të pavërteta që shkojnë në kufijtë edhe të veprave penale të tjera në dëm të viktime akuzuese.

26. Për pasojë, në cilësinë e viktimave akuzuese, Anëtarët e Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratik si i vetmi Organ Drejtues në Partinë Demokratike pas datës 11 dhjetor 2021, kanë të gjithë legjitimitetin të pretendojnë se, këto akuza të të akuzuarit Kreshnik Çollaku cënojnë haptazi reputacionin, nderin dhe dinjitetin e tyre, në sytë e publikut të gjërë.

27. Këto deklarata të bëra publike në media të ndryshme, **nuk janë gjykime vlerësuese apo opinione, që me të drejtë mund të japë i akuzuari për shkak të postit të tij, por janë akuza konkrete për një vepër të rëndë penale që po vazhdon të konsumohej nga Anëtarë të Komisionit të Rithemelimit, kundër interesave të anëtarëve të vetë Partisë Demokratike dhe gjithë qytetarve më gjërë, të cilat nuk mund të justifikohen se janë bërë për shkak të pozicionit personal të të akuzuarit.**

28. Këtë deklaratë të deputetit Kreshnik Çollaku në dëm të Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratik se ata “Po mbështeten nga influencat ruse dhe Kisha Ortodokse” (duke aluduar për z. Sali Berisha), i konsiderojmë si “Shpifje”, të kryera botërisht ndaj Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratik, vepër penale e parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal.



29. Lidhur me këtë kërkesë penale, do i referohemi edhe dispozitave ligjore të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ( më poshtë KEDNJ), jurisprudencës vendase të Gjykatës së Lartë (më poshtë GJL) asaj të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë GJEDNNJ), si dhe Kodit Penal.

30. Nga përmbajtja dhe interpretimi i dispozitave të mësipërme, parimisht nxjerrim konkluzionin se *“... liria e shprehjes dhe e informimit është e garantuar dhe e mbrojtur nga ligji për këdo, por kjo liri mund t’u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj në rastet kur (veç të tjerash) prek moralin, nderin, dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Parashikimi në Kodin Penal i veprave penale të fyerjes dhe shpifjes dhe sanksionet që ato përmbajnë, janë pikërisht masat që me ligj janë marrë për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit të personit.”*

31. Cënimi i këtyre marrëdhënieve pas sjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t’u cilësuar nga ligji si vepër penale duhet që:

31.1. Objekt i veprës penale të jetë ndjenja e nderit dhe dinjitetit të personit, emri i mirë apo reputacioni i personit fizik a juridik, në kuadër të vlerësimit që ai gëzon në opinionin shoqëror;

31.2. Sipas nenit 120 të Kodit Penal, nga ana objektive i pandehuri me veprime aktive, të kundërligjshme përhap verbalisht, duke biseduar me persona të tjerë, me shkrim, etj..., fakte të pavërteta dhe të rreme për personin e dëmtuar.

Në këtë kuptim, referuar dispozitave ligjore, autori i veprës penale, i akuzuari Kreshnik Çollaku duhet që:

- Të përhapë thënie apo, çdo informacion tjetër, me shkrim, me gojë apo në çfarëdo mënyrë tjetër;
- Thëniet apo informacioni të jenë të rremë, çka nënkupton se jo vetëm objektivisht ky informacion duhet të jetë i rremë, por se edhe subjektivisht, personi që i përhap ato ta dijë se janë të rreme. Ky element e dallon këtë vepër nga “fyerja”, për të cilën nuk nevojitet që informacioni të jetë domosdoshmërisht i rremë, ai mund të jetë dhe real, por diskretitues, mjafton që të cënojë ndjenjën e dinjitetit të personit;
- Thëniet apo informacioni të jenë konkretë;



- Thëniet apo informacioni të jenë diskretituese, me qëllim cënimin e nderit dhe dinjitetit të personit, të cilit i adresohen;
- Nëse këto veprime bëhen botërisht apo, në dëm të disa personave apo, më shumë se një herë, vepra do të cilësohet sipas paragrafit të dytë të nenit 120 të KP;

**31.3.** Po kështu, subjekti i veprës penale të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 16 vjeç.

**32.** Nga ana subjektive, kjo kundërvajtje penale kryhet me dashje direkte. **Element cilësues, pa të cilin kjo vepër nuk mund të ekzistojë është qëllimi – dashja e drejtpërdrejtë për të poshtëruar e diskretituar nderin dhe dinjitetin e personit, me qëllim që opinioni shoqëror të ndryshojë në mënyrë pexhorative, vlerësimin që ka për këtë të fundit.**

- *Pozicioni i kërkuesit dhe personit ndaj të cilit është shpifur;*
- *Natyra dhe objekti i deklaratave të pretenduara poshtëruese;*
- *Kualifikimi/cilësimi i tyre si deklaratë fakti apo opinione;*
- *Fjalët e përdorura;*
- *Ekzistenca e provave për vërtetësinë e deklaratave të pretenduara shpifëse.*
- *Kontributi i shprehjeve me natyrë diskretituese në një debat me interes të përgjithshëm;*
- *Niveli i famës së personit, reputacioni i të cilit është cënuar;*
- *Argumenti i komunikimit;*
- *Sjellja e personit ndaj të cilit është kryer shpifja përpara deklaratës së pretenduar shpifëse;*
- *Metodat e përdorura për të marrë informacionet dhe vërtetësia e këtyre të fundit;*
- *Përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit.*

**33.** Bazuar në dispozitat kushtetuese, ato të KEDNJ si dhe jurisprudencës vendase dhe asaj të GJEDNJ, theksojmë se, liria e shprehjes është një e drejtë thelbësore e garantuar nga legjislati i brendshëm dhe ai ndërkombëtar. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e të tretëve, apo autoriteteve publike, duke respektuar kufijtë ligjor.





**33.1. Liria e shprehjes**, së bashku me **të drejtën e informimit**, si liri dhe të drejta themelore në një shoqëri demokratike janë një parakusht për të gëzuar liritë dhe të drejtat e tjera dhe garantohen nga Nenet 17, 22 e 23 të Kushtetutës së Shqipërisë.

**32.2. Liria e shprehjes** garantohet edhe nga Nenet 8 dhe 10 i KEDNJ me titull "*Liria e shprehjes*". Për më tepër GJEDNJ i ka zgjeruar shumë kufijtë e lirisë së shprehjes.

**33.3.** Kjo Gjykatë thekson se kjo e drejtë përfshin lirinë e zotërimit të bindjeve, si dhe të marrjes apo transmetimit të informacioneve dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve shtetërorë.

**34.** GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka zbërthyer raportin ndërmjet lirisë së shprehjes së individit, lirisë së shtypit, radios dhe televizionit, si dhe të drejtës së informimit, referimi tek të cilat i shërben gjykatës për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. GJEDNJ i jep më tepër rëndësi disa elementëve si:

**35.** Në këtë drejtim, jurisprudenca e kohëve të fundit e GJEDNJ ka zhvilluar një metodologji, ku janë shprehur faktorët që merren në konsideratë gjatë gjyqimit/vlerësimit të balancës mes Nenit 10 dhe Nenit 8 "*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*" të KEDNJ.

**35.1.** Me qëllim që të ketë shkelje të nenit 8 të KEDNJ, **cënimi i reputacionit duhet të ketë një farë niveli ashpërsie/të ngrihet në një nivel të tillë ashpërsie, sa të kompromentojë kënaqësinë personale të së drejtës për jetë private të personit të cënuar.**

**35.2.** Po kështu është trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ se **çfarë lloj pohimesh shpifëse përbëjnë një ndërhyrje në "jetën private" të personit të cënuar.** Në rastin "*K..... kundër Hungarisë*", GJEDNJ u shpreh se KEDNJ mbron nëpërmjet nenit 8, aspektet thelbësore të reputacionit të individit, siguron mbrojtje "*nga pretendimet apo akuza faktike të një natyre të tillë seriozisht ofenduese, sa që publikimi i tyre do të kishte një efekt të pashmangshëm, të drejtpërdrejtë në jetën private të kërkuesit*" dhe jo thjesht në vlerësimin e jashtëm të individit. Cilido qoftë ky "*prag*", është e qartë se GJEDNJ njeh të drejtën e "*reputacionit*" dhe e nxjerr atë nga koncepti i jetës private.

**36.** GJEDNJ në vendimin e saj të datës 17.12.1976 "*H.....kundër Britanisë së Madhe*", është shprehur se "*Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetërealizimin e individit. Ajo nuk mund të përfshijë vetëm informacionet dhe opinionet e perceptuara pozitivisht,*



## Partia Demokratike

*ose të konsideruara si të padëmshme, apo indiferente, por edhe të tilla që fyejnë, turbullojnë, apo që janë shqetësim për shtetin ose për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat një shoqëri demokratike nuk mund të ekzistojë”.*

**37.** Në rastin e politikanëve GJEDNJ ka theksuar se, toleranca e tyre ndaj deklaratave do të jetë më e madhe se, në rastin e personave të tjerë, por **kurrë nuk ka parashikuar imunitet absolut ndaj personave që bëjnë deklaratime shpifëse ndaj politikanëve për shkak se, para se të jenë politikanë, këta të fundit janë individë dhe si të tillë i’u garantohen të drejtat dhe liritë themelore nga KEDNJ njësoj si të gjithë individëve, sikundër është edhe mbrojtja e emrit, nderit, dinjitetit e reputacionit nga shpifja.**

**38.** Gjatë viteve GJEDNJ ka vënë theksin në idenë se, **kufizimet ndaj lirisë së shprehjes, të cilat prekin çështjet e interesit publik dhe që kuptohen në aspektin e gjerë, duhet t’i nënshtrohen një arsytimi të posaçëm.** Në këtë aspekt GJEDNJ ka deklaruar se *“Fushëveprimi për kufizimet ndaj fjalimeve a debateve politike lidhur me çështjet e interesit publik është i vogël”.* **Kjo lidhet ngushtë me qëndrimin e GJEDNJ për rëndësinë e lirisë së shprehjes si një shtyllë e demokracisë.**

**39.** Gjithashtu, GJEDNJ është shprehur se *“Kufijtë e kritikës së pranueshme janë ... më të mëdha kur kemi të bëjmë me politikanë sesa kur kemi të bëjmë me individë private. Në dallim nga këta të fundit, të parët në mënyrë të paevitueshme dhe me vetëdije e vendosin veten në një kontroll më të madh për çdo fjalë dhe vepër të tyre, ... rrjedhimisht duhet të tregojnë një shkallë më të madhe të tolerancës.”*

**40.** Ne çmojmë se, përhapja e këtyre deklaratimeve nga ana e të akuzuarit Kreshnik Çollaku, për aq kohë sa nuk ka qëllim informues, është shpërdorim i lirisë së shprehjes që mbrohet nga Nenet 17, 22, 23 e 73 të Kushtetutës dhe Nenet 8 dhe 10 i KEDNJ, si dhe është bërë me qëllim për të denigruar e njollosur nderin, reputacionin dhe vlerësimin që ka opinioni shoqëror publik ndaj Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit në Partinë Demokratike dhe ndaj Prof. Dr. Sali Berishës, në cilësinë e viktimave akuzuese.



**41.** Po kështu, e gjejmë me vend të kujtojmë këtë të Nderuar Gjykatë lidhur me gjithë praktikën e ngritur nga kolegjet e Gjykatës së Lartë (shih vendimin Nr.8 datë 05.06.2015 dhe vendimin Nr.19 datë 21.07.2015), ku qartazi është bërë dallimi midis:

- Deklarimeve bazuar në opinione;
- Deklarimeve bazuar në fakte.

**42.** Ne vlerësojmë se i akuzuari prej nesh deputeti Kreshnik Çollaku është madhor, mbi 16 vjeç, me zotësi të plotë për të vepruar si dhe ka qënë deputet i Kuvendit të Shqipërisë në disa legjislatura. Për pasojë, ai ka të gjithë aftësinë dhe kapacitetin intelektual, politik e profesional për të kuptuar:

**42.1.** Peshën e deklaramëve të tij faktike (dhe jo opinion-bërëse),

**42.2.** Nevojën për t'i mbështetur ato në prova ose të dhëna mjaftueshmërisht të sakta e të besueshme.

#### *IV- Ligji i aplikueshëm:*

Referuar dispozitave ligjore, ligji i aplikueshëm në këtë rast është Kodi Penal ku sipas Nenit 120 “Shpifja”, ku sanksionohet se:

*“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”.*

Si dhe:

- Neni 17 i Kushtetutës së RSH, i cili parashikon se **“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”** .



## Partia Demokratike

- Neni 22 i Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*;
- Neni 23 i Kushtetutës, i cili parashikon se *“E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore...”*.
- Neni 73 i Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes.”*.
- Neni 8 i KEDNJ **“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”**, i cili parashikon se: *“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”*.
- Neni 10 i KEDNJ **“Liria e shprehjes”**, i cili parashikon se *“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejte përfshin lirinë e mendimit dhe liritë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografike ose televizive. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund tu nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksione të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, **për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve**, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*.

Sa më sipër, në përfundimin konkludojmë se, deklaratat e bëra nga ana e të akuzuarit, deputetit Kreshnik Çollaku, janë qartësisht të natyrës shpifëse ndaj viktimave akuzuese, Anëtarëve të Komisionit të Rithemelimit në Partinë Demokratike në përgjithësi dhe ndaj Prof. Dr. Sali Berishës në veçanti.



## Partia Demokratike

Për pasojë, çmojmë se, me veprimet e mësipërme i akuzuari, deputeti Kreshnik Çollaku, ka konsumuar plotësisht elementët e kundërvajtjes penale të “Shpifjes” së kryer botërisht, parashikuar nga neni 120 i K.Penal, në dëm të të dëmtuarve akuzues, Anëtarë të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike, me cilësinë e organizatorve të protestës së datës 8 janar 2020 në Selinë e Partisë Demokratike.

Rrjedhimisht, i akuzuari deputeti Kreshnik Çollaku duhet të deklarohet fajtor për këtë vepër penale.

Referuar gjithë paraqitjes dhe argumentave që paraqitëm më sipër, si përfundim,

### KËRKOJMË:

Deklarimin fajtor të të akuzuarit Kreshnik Çollaku, për kryerjen e veprës penale të “Shpifjes” së kryer botërisht në dëm të të dëmtuarve akuzues Anëtarë të Komisionit të Rithemelimit të Partisë Demokratike, parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal.

Tiranë më 28.01.2022

*Ilir Meta*  
*BEKIM KULLIÇI* *Behar Keleş*  
*Edmond Spata* *Eymate*  
*Albon Vllahi*  
*Tavit Shuk*  
*Oerd Bylykboshi*  
*Leon Baci* *duy*